



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI
VENDIM
Nr. 22, Datë 18.02.2019

MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KASTRATI
ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “e”; nenit 5, pika 1 gërma “e”; nenit 10, pika 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 18.02.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me Nr. 111 Prot., datë 01.02.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gërma “b“ (bilanci financiar i tre viteve të fundit). Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, gërmat “a“ dhe “d“ (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh / sipas viteve),

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11 pika 1 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 5(pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI NË DETYRË

Adriatik BEGO